

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT 1

(PAS PROCESIT TË ANKIMIT)

Data: 03/11/2021

Drejtuar: **Operatorit ekonomik “Nika” shpk**

Adresa: Lagjja Vasil Shanto, Bulevardi Skenderbeu, godine 8-kateshe, kati i I-re, Zona kadastrale 8593, nr.pasurie 5/587”, Shkodër

Procedura e prokurimit/lotit: “Procedurë e Hapur” **“Parku i liqenit të Farkës një Pol Rekreativ për Tiranën”**.

Numri i procedurës / referenca e Lotit: REF-01875-07-28-2021

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: “Parku i liqenit të Farkës një Pol Rekreativ për Tiranën”.

Publikimet e mëparshme: Nuk ka

Buletini i Njoftimeve Publike: Buletini i Njoftimeve Publike: Buletini i Njoftimeve Publike Nr.117 datë 02.08.2021.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të kësaj ju informojmë se Ofertuesit e mëposhtëm kanë marrë pjesë në këtë procedurë me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. 1 Operatori ekonomik “Albavia” shpk
J81527001Q

NUIS

Vlera e ofertës = **12,356,147** (dymbëdhjetë milion e treqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë e njëqind e dyzetë e shtatë) lekë pa TVSH.

2. Operatori ekonomik “Nika” shpk

NUIS J76705047U

Vlera e ofertës = **16,047,368.47** (gjashtëmbëdhjetë milion e dyzetë e shtatë mijë e treqind e gjashtëdhjetë e tetë pikë dyzetë e shtatë) lekë pa TVSH.

3. Operatori ekonomik “Dajti Park 2007” shpk

NUIS K11507003S

Vlera e ofertës = **16,248,868.58** (gjashtëmbëdhjetë milion e dyqind e dyzetë e tetë mijë e tetëqind e gjashtëdhjetë e tetë pikë pesëdhjetë e tetë) lekë pa TVSH.

¹ Ky Formular është i aplikueshëm nëse ka Ankime

4. Operatori ekonomik “2N” shpk

NUIS L31615017L

Vlera e ofertës = **18,293,489** (tetëmbëdhjetë milion e dyqind e nëntëdhjetë e tre mijë e katërqind e tetëdhjetë e nëntë) lekë pa TVSH.

5. Operatori ekonomik “Leon Konstruksion” shpk

NUIS K71820009I

Vlera e ofertës = **19,776,115** (nëntëmbëdhjetë milion e shtatëqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë e njëqind e pesëmbëdhjetë) lekë pa TVSH.

6. Operatori ekonomik “Pepa Group” shpk

NUIS L42215009L

Vlera e ofertës = **21,191,274.51** (njëzetë e një milion e njëqind e nëntëdhjetë e një mijë e dyqind e shtatëdhjetë e katër pikë pesëdhjetë e një) lekë pa TVSH.

7. Bashkimi i Operatorëve ekonomik “K.M.K” shpk & “Sinder AB” shpk

NUIS L78223801E & NUIS K01531003Ë

Vlera e ofertës **23,225,217** (njëzetë e tre milion e dyqind e njëzetë e pesë mijë e dyqind e shtatëmbëdhjetë) lekë pa TVSH.

8. Operatori ekonomik “PE - VLA - KU” shpk

NUIS K61716013M

Vlera e ofertës = **24,433,622.16** (njëzetë e katër milion e katërqind e tridhjetë e tre mijë e gjashtëqind e njëzetë e dy pikë gjashtëmbëdhjetë) lekë pa TVSH.

9. Operatori ekonomik “Agi Kons” shpk

NUIS K21622001M

Vlera e ofertës = **25,052,775** (njëzetë e pesë milion e pesëdhjetë e dy mijë e shtatëqind e shtatëdhjetë e pesë) lekë pa TVSH.

Janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. Operatori ekonomik “Albavia” shpk

NUIS J81527001Q

- Në mbështetje të Nenit 92, pika 2, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe të Kreut X, Nenit 82, pika 3 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, verifikoi ofertat e kualifikuara për gabime aritmetike dhe konstatoi se oferta e paraqitur nga Operatori ekonomik “Albavia” shpk është me gabime aritmetike.
- Për sa më sipër, KVO-ja për shkak të konstatimit të ofertës me gabime aritmetike, ne mbështetje të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 82, pika 3, më datë 27.08.2021, nëpërmjet sistemit elektronik të vënë në dispozicion nga APP-ja i kërkoi Operatorit ekonomik të dërgojë me shkrim brenda datës 30.08.2021, ofertën e korrigjuar.
- Në rast të mosparaqitjes së ofertes së korrigjuar brenda datës 30.08.2021, oferta e shoqërisë do të refuzohej.

- Operatori ekonomik “Albavia” shpk nuk ka pranuar korigjimin e propozuar, e si rrjedhojë KVO vendosi të refuzojë Oferten e paraqitur nga shoqëria “Albavia” shpk.

2. Operatori ekonomik “Dajti Park 2007” shpk

NUIS K11507003S

- Në mbështetje të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 93, si dhe të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu X, Neni 82, pika 4, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, referuar formulës së përcaktuar në dokumentat e tenderit, verifikoi nëse ofertat e vlefshme janë me çmim Anomalisht të Ulët nga ku rezultoi se oferta e paraqitur nga Operatori ekonomik “Dajti Park 2007” shpk është në kushtet e Ofertës Anomalisht të Ulët.
- Për sa më sipër, KVO-ja për shkak të konstatimit të ofertës së paraqitur nga Operatori ekonomik si anomalisht të ulët, në mbështetje të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 93, pika 1, më datë 07.09.2021, nëpërmjet sistemit elektronik të vënë në dispozicion nga APP-ja i kërkoi Operatorit ekonomik të dërgojë me shkrim brenda datës 10.09.2021 ora 12:00, shpjegime për elementët e ofertës, në lidhje me zërat e preventivit të ofertës së paraqitur në tender, për të cilat kërkohet analizë kosto. Në rast të mosparaqitjes së këtij informacioni brenda datës 10.09.2021 ora 12:00, oferta e shoqërisë do të konsiderohej e papranueshme.
- Operatori ekonomik “Dajti Park 2007” shpk nëpërmjet shkresës me Nr. 34116 Prot. datë 09.09.2021 ka paraqitur analizë kosto për çmimet e paraqitura në kushtet e ofertës anomalisht të ulët.
- Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, pasi u njoh me shpjegimet e paraqitura mbi elementët e ofertës, konstatoi se argumentimet teknike të paraqitura nuk mbështeten sipas kërkesave të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 93, pika 2.
- Për sa më lart, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, gjykon se shpjegimet e paraqitura nuk janë bindëse e për rrjedhojë në mbështetje të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 93, pika 3, vendosi të refuzojë ofertën e paraqitur nga Operatori ekonomik “Dajti Park 2007” shpk.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **Operatorin ekonomik “Nika” shpk**, me adresë: *Lagjja Vasil Shanto, Bulevardi Skenderbeu, godine 8-kateshe, kati i I-re, Zona kadastrale 8593, nr.pasurie 5/587”, Shkodër*, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej **16,047,368.47** (gjashtëmbëdhjetë milion e dyzetë e shtatë mijë e treqind e gjashtëdhjetë e tetë pikë dyzetë e shtatë) lekë pa TVSH, është identifikuar si Oferta e suksesshme.

Në mbështetje të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 82, pika 5; të VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Neni 26, pika 6 si dhe referuar Dokumentave Standarte të Tenderit të publikuara, rrjedhimisht Jeni i lutur të paraqisni pranë Autoritetit Kontraktor, Bashkia Tiranë, me adresë: *Sheshi Skënderbej, Nd. 2, Kodi Postar 1001, Tiranë*, sigurimin e kontratës; dokumentat provuese për vetdeklarimet e bëra në Formularin Përmbledhës të Vetdeklarimit si dhe dokumentat e paraqitura në rrugë elektronike brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose nuk dorëzon sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj) dhe kontrata

do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej **18,293,489** (tetëmbëdhjetë milion e dyqind e nëntëdhjetë e tre mijë e katërqind e tetëdhjetë e nëntë), siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik".

Ankesat:

Në datë 17.09.2021 pranë Bashkisë Tiranë është paraqitur Formulari i Ankesës nga Operatori ekonomik "2N" shpk.

Në datë 21.09.2021 pranë Bashkisë Tiranë është paraqitur Formulari i Ankesës nga Operatori ekonomik "Nika" shpk.

Vendim i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 729/2021, date 07.10.2021.